352	Elbasan	Librazhd	EL21 00 024a	EP Dardhë-Xhyrë	24a	18.45	Pyll
353	Elbasan	Librazhd	EL21 00 024b	EP Dardhë-Xhyrë	24b	15.6	Pyll
354	Elbasan	Librazhd	EL21 00 024c	EP Dardhë-Xhyrë	24c	1.8	Kullotë
355	Elbasan	Librazhd	EL21 00 024ç	EP Dardhë-Xhyrë	24c	2.73	Kullotë

365	Elbasan	Librazhd	EL21 00 056a	EP Dardhë-Xhyrë	56a	13.96	Pyll
366	Elbasan	Librazhd	EL21 00 056b	EP Dardhë-Xhyrë	56b	18.14	Pyll
367	Elbasan	Librazhd	EL21 00 056c	EP Dardhë-Xhyrë	56c	4.31	Pyll
368	Elbasan	Librazhd	EL21 00 056d	EP Dardhë-Xhyrë	56d	9.23	Kullotë
369	Elbasan	Librazhd	EL21 00 057a	EP Dardhë-Xhyrë	57a	3.12	Pyll
370	Elbasan	Librazhd	EL21 00 057b	EP Dardhë-Xhyrë	57b	8.16	Pyll
371	Elbasan	Librazhd	EL21 00 057c	EP Dardhë-Xhyrë	57c	6.72	Pyll
372	Elbasan	Librazhd	EL21 00 058a	EP Dardhë-Xhyrë	58a	18.89	Pyll
373	Elbasan	Librazhd	EL21 00 058b	EP Dardhë-Xhyrë	58b	16.7	Shkëmbore
374	Elbasan	Librazhd	EL21 00 058c	EP Dardhë-Xhyrë	58c	10.95	Kullotë
375	Elbasan	Librazhd	EL21 00 059a	EP Dardhë-Xhyrë	59a	7.37	Pyll
376	Elbasan	Librazhd	EL21 00 059b	EP Dardhë-Xhyrë	59b	3.08	Pyll
377	Elbasan	Librazhd	EL21 00 059c	EP Dardhë-Xhyrë	59c	16.64	Pyll
378	Elbasan	Librazhd	EL21 00 059d	EP Dardhë-Xhyrë	59d	4.32	Pyll
379	Elbasan	Librazhd	EL21 00 059e	EP Dardhë-Xhyrë	59e	6.56	Pyll
Shuma						225.88	
1348	Elbasan	Librazhd	EL47 00 147b	EP Polis	147b	16.3	Kullotë
1350	Elbasan	Librazhd	EL47 00 148b	EP Polis	148b	8.42	Kullotë
1357	Elbasan	Librazhd	EL47 00 152a	EP Polis	152a	39.61	Pyll
1358	Elbasan	Librazhd	EL47 00 152b	EP Polis	152b	21.04	Kullotë
1359	Elbasan	Librazhd	EL47 00 153a	EP Polis	153a	34.29	Pyll
1360	Elbasan	Librazhd	EL47 00 153b	EP Polis	153b	55.1	Kullotë
Shuma						174.76	

PER DREJTORINE E ZHVILLIMIT EKONOMIK BUJQESISE DHE TURIZMIT

Pergjegjesi i menaxhimit

Ing. Aleksander BRAZHDA



DREJTORI

Hysni HOXHA



8/10
10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHID

AGJENCIA E FUNKSIONEVE
SEKTORI I MBROJTJES SË PYJEVE DHE KULLOTAVE

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____, Datë ____ / ____ / 2025


MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS, PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QË DO TË MERRREN NË MBROJTJEN E
PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRET.

PROGRAM-PUNE

“Për parandalimi dhe masat që do të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret”

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Ligjit 152/2015 datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, të Ligjit nr.57 datë 30.04.2020 “Për pyjet”, të Ligjit Nr.9693 datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” të ndryshuar, të V.K.M-së Nr. 290 datë 30.4.2004 “Për miratimin e strategjisë kombëtare dhe menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota”, V.K.M-së Nr. 1080 datë 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota si dhe krijimin e njësisve vullnetare të shuarjes së zjarreve”, të VKM-së Nr.684 datë 02.09.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 433 datë 08.06.2016 të keshillit të ministrave, “Për transerimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive, të ndryshuar”, hartohet ky program pune **“Për parandalimin dhe masat që do të merren për mbrojtjen nga zjarri të pyjeve dhe kullotave”**, për territorin që mbulon Bashkia Librazhd për vitin **2025**.

SKEMA E LAJMËRIMIT NË RAST ZJARRI



Nr	Masat që do të merren	Afati	Zbatuesi
1	<p>Në Bashkinë Librazhd krijohet Shtabi i Mbrojtjes nga Zjarri me përbërjen e mëposhtme :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bajram PISHKASHI Sekretar i Përgjithshëm Kryetar 2. Ermir SULOLLARI N/Kryetar i Bashkisë Anëtar 3. Sali BRANKO Shefi i Sektorit të MZSH-së Anëtar 4. Aleksandër BRAZHDA Përgj. Menaxhimi i Pyjeve dhe Kullotave Anëtar 5. Bledar ÇOTA K/Inspektor Sek. Mbrojtjes së Pyjeve Anëtar 6. Adrian KARAJ Specialis menaxhimi Anëtar 7. Ardit KULLAFI Specialis menaxhimi Anëtar 8. Qerim FACJA Insp. zone Anëtar 9. Besnik GJINI Insp. zone Anëtar 10. Latif QETI Insp. zone Anëtar 11. Roshi ÇOTA Insp. zone Anëtar 12. Juljan BICI Insp. zone Anëtar 13. Niko ALLIU Insp. zone Anëtar 14. Iris FAQOLLI Insp. zone Anëtar 15. Ilmi ÇEPI Insp. Mjedisi Anëtar 16. Florjan MËNALLA Adm. Hotolisht Anëtar 17. Gentian LUKA Adm. Orenjë Anëtar 18. Partizan BALLOLLI Adm. Polis Anëtar 19. Andon KODRALI Adm. Lunik Anëtar 20. Albert KALECI Adm. Steblevë Anëtar 21. Roland ÇOTA Adm. Qendër Anëtar 	Deri më 31.12.2025	Shtabi

Nr	MASAT QË DO TË MERREN	AFATI	ZBATUESI
1	<ul style="list-style-type: none"> • Shtabi i Mbrojtjes nga Zjarri do të ndjekë në vazhdimësi të gjitha problemet që kanë të bëjnë me masat parandaluse si dhe me masat për përballimin e situatës në rast zjarri. • Shtabi do të mblidhet çdo fund muaji dhe në rast të shfaqjes së zjarrit menjeherë pas shuarjes së plotë të tij do të bëhet analiza dhe dëmet që janë shkaktuar nga zjarri. • Në rast të shfaqjes së zjarrit do të funksionojë skema e lajmërimit bashkëngjitur këtij programi-pune. • Shtabi të mbajë lidhje të vazhdueshme me inspektorët e zonave pyjore dhe administratorët e Njësive Administrative dhe këto të fundit me kryetarët e fshatrave. 	Vazhdimisht	Shtabi
2	<ul style="list-style-type: none"> • Inspektorët e zonave së bashku me kryetarët e fshatrave të organizojnë skuadrat vullnetare për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri si dhe ripunimin e ligjit të pyjeve dhe kullotave në çdo fshat nën drejtimin e kryetarit të fshatit me 5-11 persona . • Në këto skuadra vullnetare të ketë 1-2 persona që përdorin motorsharrë.Para fillimit të punës do të bëhet instruktimi i të gjithë pjesëmarrësve në shuarjen e zjarrit duke vënë theksin në mbrojtjen e shëndetit. 	Deri 15 maj 2025	Insp.zonave Kryetarët fshatit Sektori MZSH Administratorët
3	<ul style="list-style-type: none"> • Për shuarjen e zjarreve do të mbahet në gadishmëri të plotë baza 4opulate e nevojshme (veglat e punës,fikset etj) sipas inventarit përkatës. 	Vazhdimisht	Insp.zonave

4	<ul style="list-style-type: none"> • Pikat e vrojtimit në mënyrë që të mbulohet i gjithë fondi pyjor nga vrojtuesit do të jetë si mëposhtë: ❖ Në fshatin Babje në vendin e quajtur Qafa e Gajorit. ❖ Në fshatin Spathar në vendin e quajtur Guri i Skenderbeut. ❖ Në fshatin Arres në vendin e quajtur Bregu i Gjatë. ❖ Në fshatin Semes në vendin e quajtur Qafza. ❖ Në fshatin Togëz në vendin e quajtur Zgara. ❖ Në fshatin Polis në vendin e quajtur Qafë-Dardhë ❖ Në fshatin Dardhë në vendin e quajtur Bace. ❖ Në fshatin Xhyrë në vendin e quajtur Qafa e Lesmit. ❖ Në Ekonominë Çermenikë në vendin e quajtur Guri i Muzhaqit. ❖ Në ekonominë Steblevë në vendin e quajtur Mali Zylit. ❖ Ne ekonomine pyjore Neshte –Prevalle ne vendin e quajtur Qafa e Prevallit <p>Shënim: Kryetarët e fshatrave për çdo fshat që ata kanë nën administrim do të kenë pikat e tyre lokale të vrojtimit në bashkëpunim me banorët e fshatrave përkatës dhe do të jenë të parët që në bashkëpunim me inspektorët e zonave pyjore do të bëjnë njoftimin dhe organizimin e punës për eliminimin pasojave në rast zjarri.</p> <p>Njoftimi do të kryhet sipas skemës përkatëse që i bashkëngjitet këtij programi pune.</p>	Vazhdimisht	Insp.zonave
5	<ul style="list-style-type: none"> • Për ndjekjen në vazhdimësi të problemeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri inspektorët e zonave pyjore të jenë në kontakt të vazhdueshëm me komunitetin lokal,për kryerjen e punës sensibilizuese,parandaluese,dhe në rast zjarri marrjen e masave të menjëhershme. 	Vazhdimisht	Insp.zonave
6	<ul style="list-style-type: none"> • Për çdo rast të shfaqjes së zjarrit do të bëhet analizë e veçantë dhe do të dilet me propozime konkrete. 	Vazhdimisht	Shtabi
7	<ul style="list-style-type: none"> • Të ndiqen në vazhdimësi plotësimi i nevojave me bazë materiale për fikjen e zjarreve. 	Vazhdimisht	Shtabi

8	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me institucione të tjera duke siguruar numrat e telefonave të personave të ngarkuar sipas dhenave specifike të secilit institucion. <ul style="list-style-type: none"> ❖ Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. M.Z.SH ❖ Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit IKMT ❖ Njësitë Administrative të Bashkisë Librazhd/Kryetaret e fshatrave. ❖ Emergjencat Civile ❖ N/Prefekturen Librazhd ❖ Policine 	Vazhdimisht	Shtabi
9	<ul style="list-style-type: none"> • Pasqyrimi në dokumentat kadastrale i dëmeve e pasojave në rast zjarresh, në bazë të evidencave të përgatitura për Drejtorinë e Pyjeve dhe M.Z.SH. 	Vazhdimisht	Përsoneat pergjegjës
10	<ul style="list-style-type: none"> • Masat propagandistike për sensibilizimin e popullatës për rrezikshmërinë dhe pasojat që sjellin zjarret në pyje dhe kullota, pasojat në mjedis etj. (informacione, parrullave, afisheve, medjave lokale, me barijtë ,nxënësit e shkollave,) 	Vazhdimisht	Shtabi
11	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunimi me subjektet e ndryshme (persona fizikë dhe juridikë) që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor/kullozor, për aktivizimin e burimeve njerëzore dhe materiale në rast zjarresh. 	Vazhdimisht	Inspektorët e zonave pyjore

SHTABI I MBROJTJES SË PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRI

(Numrat e Telefonit për komunikim në rast Zjarri)

Nr	EMËR	MBIEMËR	NUMRI I TELEFONIT
1	Ermir	Sulollari	069 391 3302
2	Bajram	Pishkashi	068 200 5100
3	Sali	Branko	069 768 8877
4	Aleksandër	Brazhda	068 552 2154
5	Bledar	Çota	069 941 9306
6	Adrian	Karaj	069 661 6594
7	Ardit	Kullafi	069 422 2840
8	Qerim	Fajca	068 325 7284
9	Besnik	Gjini	069 278 8485
10	Latif	Qeti	068 538 8399
11	Roshi	Çota	069 514 7199
12	Juljan	Bici	069 666 6326
13	Niko	Alliu	068 803 0452
14	Iris	Faqolli	069 569 6768
15	Ilmi	Çepi	069 636 1475
16	Albert	Kaleci	067 430 6495
17	Andon	Kodraniu	068 385 4187
18	Roland	Çota	069 444 2014
19	Partizan	Ballolli	068 239 3465
20	Gentian	Luka	069 235 0690
21	Florian	Mënalla	069 489 3102

P/AGJENCIA E FUNKSIONEVE

Sektori Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave
K/Inspektori
Ing. Bledar Çota

DREJTORI
Elisabeta Alla

aw
Sek. Keshillit

399
DT22.01.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK BUJQESISE DHE TURIZMIT
SEKTORI I TURIZMIT

Nr. Prot. Librazhd më, .01.2025

LËNDA : Informim mbi veprimtarine e sektorit te Turizmit, pjese e programit te Bashkise Librazhd

DREJTUAR : Keshillit Bashkiak Librazhd .

Te nderuar keshilltare!

Se pari ju pergezroj per rolin tuaj te pazevendesueshem ne sherbim te qytetareve dhe zhvillimit te komunitetit,permes vendimeve qe hapin rrugen per zbatim, projekteve zhvilluese dhe vizionare .

Draft strategjia Kombëtare e Turizmit 2024-2030 përcakton qartazi turizmin si një ndër shtyllat bazë dhe më me potencial për zhvillimin ekonomik të vendit dhe rritjes së të ardhurave për frymë , përmes zhvillimit dhe shfrytëzimit të potencialit të plotë turistik që Shqipëria ofron. Menaxhimi dhe marketingu i destinacioneve dhe ngritja e kapaciteteve janë pjesë thelbësore e kësaj draft strategjie respektivisht në faqet 86, 87 dhe 112. Ndërkohë që draft strategjia parashikon ngritjen e strukturave të posaçme si OMD-te (Organizata të menaxhimit të turizmit në nivel vendor), ORM (Organizata Rajonale te Menaxhimit) dhe KMD (Kompanitë për menaxhimin e destinacioneve), bashkia Librazhd , sektori i turizmit po përgatitet ti paraprijë këtij bum zhvillimi ne mënyrë që stafet e angazhuara në turizëm, të rinj dhe gjithë komuniteti të jenë më të përgatitur dhe të gatshëm për tu futur në tregun e zhvillimit përmes turizmit.

Në një pamje të përgjithshme tek çdokush që do hidhte sytë nga Shqipëria turistike vijnë destinacione kryesore të turizmit detar dhe malor, ku Parku Kombëtar Shebenik me Stëblevën mund të spikatin, por vërshimi turistik në Shqipëri do të kërkojë depërtim me hapa të shpejtë në komunitet ashtu siç dhe strategjia parashikon në faqen 104 të saj në lidhje me “Turizmi i bazuar në komunitet”.

Zona e Librazhdit, me një pozitë gjeografike dhe fizikisht shumë pranë destinacioneve më të njohura turistike, ofron në çdo fshat, në çdo traditë perla turistike në turizëm malor, agro kulturor dhe etnografik. Ndërgjegjësimi për ti identifikuar dhe vënë në dukje këto elementë dhe formimin e panoramës së plotë është akoma në hapat e parë dha ka nevojë për nxitje dhe shtysë.



Aktualisht bashkia Librazhd ka një strukturë me 4 staf të fokusuar në mbarëvajtjen e turizmit dhe çuarjen përpara të planeve lokale dhe kombëtare me në fokus turizmin. Rritja e kapacitetit të vetë stafit për të parë përtej dhe identifikuar çdo burim të mundshëm, të dallojmë dhe dokumentojmë të bukurën përmes fotosh, videosh e publikimesh në platforma të mirëfillta si dhe mbështetja me mjetet e duhura logjistike që ky staf të aksesojë në baza të rregullta komunitetin dhe potencialin që kërkon të identifikojë për të çuar përpara zhvillimin turistik. Vjen domosdoshmëri pajisja e strukturës së turizmit me eksperiencë dhe modele të implementuar në vendet analoge turistike. Kjo strukturë dhe stafi i saj do jenë më pranë komunitetit duke fuqizuar ato familje të cilat kanë nisur të kenë vëmendjen dhe zhvillimin e aktiviteteve familjare për gjenerim të ardhurash me në fokus turizmin, duke identifikuar dhe informuar familje të reja për potencialin e tyre dhe se si mund të fillojnë të përfshihen në këtë lloj mënyre gjenerim të ardhurash, ashtu si dhe planifikojnë të jenë sa më pranë grup moshës së re duke i kthyer të rinjtë në partnerë të përditshmërisë në komunitet, duke ju krijuar mundësi për organizim aktiviteteve, trajnime se si ata vetë mund të promovojnë zonën e tyre përmes aktiviteteve masive, fotografisë dhe udhë rrëfimit. Aktualisht kjo strukturë në bashki gjendet e gatshme për kontribut, por kërkohej akoma mbështetje logjistike dhe rritje kapaciteti përmes trajnimeve me nevojë specifike. Familjet dhe komuniteti në gjithë bashkinë Librazhd me potencial për tu përfshirë në aktivitete turistike është shumë më i madh përkundrejt atyre familjeve që e kanë përqaftuar si ide dhe janë në përpjekjet e tyre të para për të ngritur aktivitetet e tyre. Është i domosdoshëm depërtimi me aktivitete, bisedat komunitare, për të ndërtuar zinxhirin e vlerës dhe një plan zhvillimi se si secili fshat dhe familjet brenda tij mund të angazhohen në kthimin e fshatit në atraksion turistik dhe roli i secilit brenda kësaj në bazë të kapacitetit dhe çfarë secili mund të ofrojë. Familjet mund të kuptojnë se nëse disa prej tyre kanë kapacitet dhe mundësi të hapin dhoma për akomodim, disa të tjerë mund të bashkëpunojnë duke siguruar produktet bio nga tufat që mbarështojnë apo duke ngritur kopshte e ferma të aksesueshme nga turistët vendas dhe të huaj. Ndërkohë që të rinjtë janë në fazën e organizimit të aktiviteteve sporadike, përmes krijimit fillimisht të një grupi rinor për turizmin me përfaqësi nga të gjitha shkollat e mesme në bashki. Struktura e turizmit në bashki synon angazhimin e tyre të mirëfilltë duke i kthyer në ambasadorë të promovimit, përmes rritjes së kapaciteteve të tyre në zhvillim aktiviteteve me natyrë ndërgjegjesimi. Aktivitete që mund të nxisin të rinjtë që në moshë të hershme të mendojnë strategjikisht për të ardhmen e tyre në vend.

Bashkia Librazhd me 7 Njësi Administrative dhe 52 fshatra, ndodhet në një pozitive gjeografike mjaft të favorshme ku në çdo fshat dhe lagje është mundësia për shndërrim në atraksion turistik. Bazuar në "Strategjia e zhvillimit të territorit Librazhd dhe Prrënjat të 2017" rezulton se në gjithë bashkinë Librazhd ka: a) 138,882 ha zona të rëndësishme kombëtare dhe zona të mbrojtura, 26 monumente natyrore, 15 monumente kulturore dhe 35 km rrugë Egnatia.

Bazuar në raportin e World Vision Albania të vitit 2020 "Vlerësimi i Peisazhit dhe burimeve natyrore Librazhd", fq. 32 rezulton se emigrimi sezonal është burimi kryesor i të ardhurave në zonë ku 90.4% e familjeve të intervistuar deklarojnë këtë fakt ashtu siç pohojnë se nëse më parë këto të ardhura mjaftonin për të ndërtuar shtëpi tani janë të kufizuara dhe po shfrytëzohen për shpenzime të përditshme. Kjo është një tregues që komunitetet në Librazhd akoma shikojnë



emigrimin si zgjidhje për të ardhura të përditshme të tyre dhe nuk janë të ndërgjegjësuar dhe mirë informuar se si të mund të shfrytëzojnë burimet natyrore që zona ka.

Referuar informacioneve zyrtare të Ministrisë së Mjedisit, Rrjetit të Zonave të Mbrojtura të vitit 2014 ,të përgatitur nga Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura, sektori i zonave të mbrojtura në territorin e bashkisë së re Librazhd përfshin:

Parku Kombëtar Shebenik - kategoria II, me sipërfaqe 33,927.7 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri miratuar me VKM nr.640, datë 21.05.2008;

Parku Natyror Rajonal Kuturman, kategoria IV, me sipërfaqe 3,600 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri shpallur me Rreg. MB nr.1, datë 27.7.1977;

Parku Natyror Rajonal Polis, kategoria IV, me sip. 45.0 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri miratuar me VKM nr.102,datë 15.01.1996;

Parku Natyror Rajonal Sopot, kategoria IV, me sip. 300 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri miratuar me VKM nr.102, datë 15.01.1996;

Parku Natyror Rajonal Dardhë - Xhyrë, kategoria IV, me sip. 400 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri miratuar me VKM nr.102, datë 15.01.1996.

Diversiteti natyror në parqe dhe përreth tyre është shumë i pasur, si për nga flora ashtu edhe nga fauna. Parqet kanë drurë ahu, pishë e zezë, bredh, lis, mështekna, arneni, bush, ajdes, panjë, shelg, lajthi, shkozë, mëllezë, vidh, vodhëz të egër, qershi të egër, boronicë, gorricë, dardha të egër, trëndafil të egër, çaj mali, sanza dhe më i rralli, endemiku ylli i alpeve, etj. Speciet kryesore të faunës janë: ariu i murmë, ujku, vjedulla, dhelpra, ketri, nusja e lalës, shqiponja, skifteri, etj. Më të rrallë janë: zardafi,

Treva numëron edhe 26 monumente të tjera natyrore, të listuara si të kategorisë së parë. Përmendin rrugën Egnatia, Kishën e Koshorishtit, ndërtuar në një shpellë në shek. II para erës sonë; dhe distancën e shkurtër nga zona të tjera me rëndësi arkeologjike. Librazhdi është pjesë e rrugëtimeve të turizmit historik. Zona ka kapacitete shumë të favorshme për turizëm malor. Zona e Librazhdit shquhet për folklorin e pasur, kostumet popullore të veçanta dhe zanatin e ndërtimit të shtëpive. Kjo zonë ka kultivuar gjithashtu mjeshtërinë e përpunimit të gurit dhe të drurit. Ka ndërtimet karakteristike si psh. fshati Llangë me shtëpi karakteristike me mure guri, trekatëshe, shumëvjeçare; liqenet karstike Shebenik, liqenin e Fushë Studnes, Vlaskën, fushën e Dorëzit, Bredhin e Fushë Kuqes, Rrapin e Taksimit, Shkallën e Skënderbeut, Gurrën e Ariut, e shumë të tjera. Afërsia ndaj rrugës kombëtare dhe tradita prodhuese janë mundësi të zhvillimit të zonës

Megjithë këto resurse turizmi në zonë akoma është në fazat e para të zhvillimit. Vizitorët janë të pakët dhe të vetëorganizuar..

Analiza SWOT në raportin e World Vision Albania përmendur më sipër liston ndër: A) pikat e forta – Tradita, klima, Prezenca e shembujve të mirë të aktivitetit turistik. B) pikat e dobëta – relievi i thyer dhe kushte të vështira pune për bujqësi, institucione të papërshtatshme, veçanërisht shërbime këshillimore jo të plota, C) mundësitë - mundësi të shfrytëzimit të tokave të defavorizuara, organizimi i fermerëve të vegjël dhe të mesëm në mënyra informale, mundësi për zhvillimin e bujtinave dhe zhvillimin e produkteve dhe traditave ushqimore lokale, D) rreziqet – emigrimi i vazhdueshëm, mungesë e integritimit me tregjet urbane.



Në vazhdimësi Bashkia Librazhd ka qënë në përpjekje për të shfrytëzuar mundësitë dhe minimizuar risqet dhe zhvillimi i turizmit në zonë është përgjigja, arsye për të cilën organograma e bashkisë tashmë përmban strukturë dhe sektor specifike për turizmin. Strukturë e cila duke qënë në hapat e para është në nevojë për mbështetje në ngritje kapacitetesh dhe mjete logjistike që do të vijnë në ndihmë zbatimit të planeve të punës me fokus prezencën në komunitet dhe shndërrimin e kësaj strukture në institucione të përshtatshme dhe shërbime këshillimore të plota. Komuniteti, familje për familje, të rinjtë kanë nevojë për informim, ndërgjegjësim, këshillim dhe trajnim se si mund të shfrytëzojnë mundësitë dhe të minimizojnë riskun më të madh, atë të emigrimit, dhe fuqizimi i strukturave të posaçme për ta bërë këtë dhe rritur bashkëpunimin mes banorëve dhe bashkisë është zgjidhja më afatgjatë dhe që ofron qëndrueshmëri. Prandaj ky projekt vjen i domosdoshëm për të shënuar ndryshimin dhe kthimin e bashkëpunimit komunitet dhe institucione në pikën më të fortë për zhvillimin e zonës dhe rritjen e të ardhurave nga turizmi, veçanërisht ai me bazë në komunitet.

Ndër vite bashkia Librazhd ka realizuar plane që do kontribuonin në promovimin e zonës dhe kthimin e vëmendjes të turizmit vendas dhe të huaj drejt kësaj zone. Planet kanë përmbajtur aktivitete të promovuara në rrjete sociale e media prestigjioze kombëtare. Të tilla kanë qënë ‘Festa e mjaltit’, ‘Festivali i yjeve’, ‘Festa e Stëblevës’, ‘Festivali i Valles Popullore, Librazhd 2024’ e të tjera që kanë kthyer vëmendjen drejt zonës dhe me këtë projekt është momenti që të përgatitim zonën dhe komunitet për të pritur fluksin turistik dhe të marrin më të mirën nga kjo mundësi bazuar në plane afatgjata dhe që synojnë qëndrueshmëri. Bashkia Librazhd, struktura e turizmit, ka qënë e fokusuar në planet kombëtare për promovimin dhe kanë mundësuar promovimin dhe pjesëmarrjen a fermerëve , artizanëve nga Librazhdi në gjithë eventet kombëtare të promovimit si psh. Panairi ‘Shqipëria punon tokën’. Ky projekt do jetë plotësues dhe 100% në mbështetje të planeve të sektorit të turizmit në bashki dhe rezultatet e pritshme do ndërthuren me arritjet totale të kësaj drejtorie për 2025-2026.

Ky projekt është nisma e parë në llojin e tij ndërmarrë nga sektori i turizmit në bashki dhe nuk është vazhdim i një projekti të mëparshëm. Projekti përrëputhet qartazi me Planet strategjike të Bashkisë Librazhd për zhvillimin e zonës dhe me Draft Startegjinë Kombëtare të Turizmit për 2024-2030 ku i vihet theks identifikimit të mëtejshëm të resurseve turistike në detaj, ndërgjegjësimit të komunitetit, promovimit dhe zhvillimit të turizmit me bazë në komunitet.

Bazuar ne Draft Strategjine Kombetare per Turizmin 2024 -2030 ne perputhmeri me cdo mundesi qe bashkia jone ofron , stafi i turizmit ka hartuar dhe zbatuar me pergjegjesi aktivitete me fokus turizmin e qendrueshem. Cdo aktivitet i zbatuar nga kjo zyre eshte zhvilluar ne baze te Vizionit ,Misionit dhe Qellimit te vendosur qe ne fillim te punes tone ne fushen e turizmit.

Vizioni:Librazhdi destinacioni i pashmangshëm turistik me struktura lokale, grupe interesi, familje dhe individë të fuqizuar në krijimin e një mjedisi favorizues për një ekonomi progresivisht në rritje për çdo familje.



Misioni: Strukturat lokale, komuniteti, te rinjte , dhe familjet ne Librazhd punojne sebashku per ta shnderruar ate ne nje vend te lakmueshem per te punuar, jetuar dhe vizituar permes identifikimit, mbeshtetjes dhe ekspozimit te shembujve reale qe do nxisin shumefishim te tyre nga vendasit dhe vershim per ti shijuar nga vizitorët.

Qëllimi:Të sjellim sebashku komunitetet lokale dhe vizitorët ne Librazhd, për nje jetese me cilësi dhe mirëqënie per cdo familje dhe promovim e të kuptuar të kulturave e bukurive natyrore nga vizitorët.

ÇFARE ESHTË ARRITUR GJATE KESAJ PERIUDHE ?

1- Indetifikimi dhe kategorizimi i atraksioneve , operatoreve te sherbimeve ,organizatave lokale dhe kombetare me drejtim turizmin.

Pergjate kesaj periudhe ne bashkepunim ndersektorial me bashkine , biznese ne fushen e turizmit dhe komunitetin eshte arritur indetifikimi i atraksioneve,sherbimeve , organizateve lokale, kombetare qe veprojne ne territorin e bashkise Librazhd. Si rezultat disponojme databaza per cdo kategori te lartpermendur . Jane gjeneruar te dhena dhe statistika mbi emertimin ,kategorizimin ,historikun per cdo atraksion , operator dhe organizata. Keto te dhena jane prodhuar me baza te rregullta ne komunitet dhe institucione te ngjashme me focus mjedisin . Jane ne dispozicion per cdo investitor,organizate locale dhe kombetare qe do zbatojne projekte integrimi me ceshtjet e turizmit te qendrueshem.

2- Organizimi i festave dhe panairove ne nivele lokale dhe kombetare.

Tashme ne Bashkine tone eshte krijuar nje tradite shume e mire ne drejtim te organizimeve te aktivteteve te ndryshme ,festa lokale ,panaire ne nivel local dhe kombetar.Sigurisht per turizmin keto aktivtete japim nje pamje te qarte duke promovuar cdo vlere ,tradite,kulture ,histori te komunitetit ku banojme. Aktivitetet kryesore mund te permendim :

Dita e Veres ne qender te qytetit , te rinjte dhe bizneset lokale promovuan permes simboleve te ndryshme te pranveres traditat dhe kulturat e zonave tona si mundesi atraksionesh per turizmin ne te ardhmen.

Rreth 10 biznese moren pjese ne panairin e zhvilluar nga Ministria e Bujqesise , “Shqiperia punon token” Per 2 dite fermeret tane promovuan produktet, punimet e gurit, drurit, punime qilima dhe veshje popullore.

Hapja e sezonit turistik ne muajin Prill 2024 . Per here te pare organizohet celja e sezonit turistik per bashkine tone.37- biznese promovuan produktet, guida, sporteve, produkte artizanale dhe veshje popullore.Prezenca e 45 turisteve te huaj Italiane pershkallezoi me shume njohjen nga ana



e tyre traditat ,kulturen dhe produktet e zones tone si mundesi per te terhequr vizitore te tjere te huaj apo vendas.

17 - Biznese moren pjese ne promovimin e produkteve dhe sherbimeve ne panairin e zhvilluar nga Ministria e Bujqesise ne bashkepunim me Bashkine Tirane “ Panair i ushqimit” Ishte me interes shkembimi i eksperiencave te fermerëve tane me biznese te tjere te suksesshem ne Shqiperi. Gjithashtu u perfaqesuan si staf ne panelet e diskutimit per problemet qe hasin fermeret dhe planet zgjidhese qe do mbeshtetin zinxhirin e vleres per turizmin.Per mbeshtetjen e aktivitetit kemi realizuar marreveshje me BKT, UBA dhe OTP bank ne Librazhd duke siguruar financim te mjaftueshem.

Per realizim me sukses te planeve tona mbi turizmin ,kemi siguruar nje bashkepunim te mire me strukturat brenda Bashkise si zyra e projekteve, zyra e kultures dhe urbanistika. Ky bashkepunim na ka ndihmuar per te sjelle ide te ndryshme dhe te aplikojme konkretisht ne thirrjet te ndryshme nga donatorët me focus turizmin.

Shkembimet e eksperiencave ne Bashkine Berat dhe Elbasan na kane treguar qartazi se si te rritim rezultatet ne punen tone. Tani deklarojme se puna e ndertuar ne 10 muaj, garanton sukses ne planifikime bazuar ne dokumenta dhe statistika konkrete dhe te indentifikueshme .

“Festa e Mjaltit” tashme feste tradicionale e pervitshme ku prodhuesit tane te mjaltit dhe produkteve te tjera bujqesore ,blegtorale jane mundesi jashtezakonisht e mire per nderveprimin me restorantet dhe bujtinat ne funksion te turistëve.

‘Festivali i Yjeve ‘ me shume se 6000 persona moren pjese ne vrojtimin e yjeve dhe trupave qiellore. Aktivitet qe eshte kthyer ne atraksion turistik per pasionantet e galaktikes.

3- Promovimi permes rrjeteve sociale i gjithe produkteve turistike per zonen.

Permes faqes “ Vizito Librazhdin” jane promovuar ne menyre te vazhdueshme atraksione qe jane te aksesueshme dhe gjithe veprimtaria e operatoreve lokale si bujtina,restorante,vlera historike,kulturore te zones si thesare te rendesishme per kthimin e tyre ne vlera per rritjen e interes te turistëve vizitore. Gjithashtu ne google maps jane hedhur si vendodhje rreth 30 restorante,bujtina dhe atraksione te ndryshme. Permes mediave televizive jane promovuar aktivitetet me te rendesishme ekonomike ,vlera natyrore,kulturore dhe historike te gjithe zones .Per vazhdimesine synojme rritjen e cilesise jo vetem ne promovim, por nderhyrjet ne infrastrukruren rrugore,sinjalistike,fletepalosje dhe ngritjen e pikave informuese per turistet te cdo lloj sherbimi me vlere .Nje aspekt me shume interes shikojme angazhimin e te rinjve ne aktivite qe lidhen me promovimin. Do kemi nje bashkepunim me gjithe te rinjte ne zone,per tu kthyer atyre deshiren per te qendruar dhe punuar ne vendin tone. Te rinjte do jene protagoniste dhe promovuesit me te rendesishem te turizmit ne Librazhd.Krijimi I grupit te te rinjve do jete nje tjetër prioritet i cili mundeson kordinimin e gjithe te rinjve sipërmarres ne aktivite te ndryshme ,per nje vend gjithmone te pelqyer nga vizitore.



4- Rritja e kapaciteteve te stafit menaxhues , te rinjte dhe komunitetit prites te turisteve.

Nje nder prioritetet me te rendesishme per rritjen e cilesise se aktiviteteve dhe objektivate te percaktuara ,mbetet pergatitja dhe trajnim i vazhdueshem i stafit menaxhues .te rinjte dhe grupet e interesit. Të rinjtë në zonë shpesh po udhëhiqen nga ndikimi i të rinjve të tjerë të cilët patën nje bum shkëputje nga bankat e shkollës që në moshat 15 dhe 16 vjeçare për të emigruar pranë vëllezërve, të afërmëve apo bashkëfshatarëve të tyre në shtete si Gjermania, Anglia, Greqia duke mos konsideruar dhe mos dhënë vetes asnjë mundësi për ndërtim të së ardhmes së tyre në vend. Sot është e domosdoshme që ky target grup të përfshihet dhe ndërgjegjësohet në moshë të hershme në mënyrë që të shohin mundësi angazhimi dhe zhvillimi në vend. Përmes aktivizmit të drejtpërdrejtë dhe trajnimit të tyre në fushën e së bukurës, promovimit dhe udhërrëfimit, synohet arritja përmes aktiviteteve e të gjithë të rinjve në zonë të cilët përmes zërit të tyre të bëhen shkak për nxitjen e të rinjve të investojnë në komunitetet e tyre dhe të ndalin vrullin e emigrimit dhe braktisjes së zonave të cilat mund të kthehen në perla turistike dhe mund tu ofrojnë mundësi gjenerimi të ardhurash me shumë ,më shumë dinjitet dhe përkatësi se sa vendet e tjera ku synojnë të emigrojnë. Ky target grup synohet të bëhet partneri i parë i stafit të bashkisë Librazhd për organizim aktivitetesh ,depërtimin në terren , identifikimin dhe promovimin e çdo resursi. Fuqizimi I te rinjve do ishte element me shume vlere per ti kthyer energjine e tyre si avokate te ndryshimeve dhe zhvillimit te qendrueshem. Do synojme qe cdo aktor nga me I rendesishmi deri te me pak I rendesisshmi te shfaqin sjellje qytetare dhe profesionale per vizitoret. Rezultati I ketij komponenti eshte kuptimi I njejte nga te gjithë per rendesine e turizmit ,duke I motivuar vizitoret te rikthehen serish ,apo te rekomandojne te tjere.

5- Lobimi per ngritje fondesh dhe permiresim politikash mbeshtetese nga shteti ne fushen e Turizmit

Sigurimi i fondeve ne cdo zbatim mbetet nje nder faktoret me te rendesishem. Ne kemi synuar te trajnojmë dhe orientojmë stafin me aftesi negociimi per sigurim fondesh nga partnere te mundshem . Duke marre parasysh se fondet tona nuk mund te mbeshtetin cdo aktivitet ,jemi perpjekur te bashkepunojme me pika te perbashketa interesi me Bankat ne nivel local duke perfituar shuma te vogla per zhvillimin e aktiviteteve tona. Mbetet tej i rendesishem sigurimi i fondeve per nderhyrjet per rikualifikimin me standarte te turizmit malor. Do jemi gjithmone ne kontakt me personat pergjegjes ne Ministrine e Turizmit ,per te kuptuar favorizimet e percaktuara ne ligj per ushtrimin e aktiviteteve me fokus turizmin. Gjithashtu vendosja e rregullave dhe standarteve per cdo operator do rriste nivelin e sherbimeve dhe sigurine e nje turizmi bashkohor. Perpjekjet do te jene edhe ne drejtim te fteses se motrave dhe vellerzeve tani qe ndodhen jashte shtetit si emigrante. Perqendrimi yne do jete ne projekte qe prekin edhe pritshmerite e emigranteve per vendin e tyre,duke siguruar transparence te plote per kontributoret.



6- Statistika dhe raporte te sakta te hyrje daljeve te turisteve ne Bashkine Librazhd

Kemi raporte dhe statistika per fluksin e turisteve si dokumenta referimi per progresin e fluksit te turisteve .Bashkepunimi me operatoret turistike qe veprojne ne zone ka bere te mundur evidentimin e gjithe turisteve qe vizitojne Bashkine tone. Ky proces na siguron informacion korrekt te fluksit dhe interesit se cfare kerkojne vizitoret vendas dhe te huaj. Eshte krijuar grupi i operatoreve ne gjithe zonen dhe bordi prej 8 anetareve si organ qe indetifikon problemet dhe planifikon per zgjidhjen e tyre. Bordi do mblidhet sa here e shikojne te arsyeshme ne problemet emergjente.

7- Monitorimi i mbarevajtjes se sezonit turistik ne bashkepunim me aktoret lokale dhe rajonal.

Sezoni veror u zhvillua ne kushte te pranueshme sigurie dhe sherbimesh. Ne bashkepunim me Prefekturen Elbasan ne fillim te sezonit u hartua plani i masave per zhvillimin e turizmit ne kushte normale si me poshte:

Mirembajtjen e infrastruktures rrugore dhe menaxhimin e mbetjeve urbane nga Bashkia

Komunikimin me gjithe operatoret aktive per zgjidhjen e problemeve ne kohe.

Organizimi dhe menaxhimi i festave lokale ne gjithe Bashkine duke sjelle atmosfere feste dhe zhvillimi ekonomik per komunitetin .

Kordinimi i masave me cdo institucion (Policia ,Zonat e Mbrojtura, OSSHE , Sektori i mirembajtjes se rrugeve, Sektori I ujesjellesit dhe kanalizimeve, Qendra Shendetesore) ndikues ne mbarevatjen e sezonit, per monitorimin e proceseve me rendesi dhe zhvillimin normal te cdo aktiviteti.

Bashkebisedim i vazhdueshem me komunitetin per nje pritje te ngrohte per cdo vizitor dhe rritjen e standartit te sherbimeve.

Probleme te identifikuara :

Kapaciteti i madh i turisteve krijoi veshtiresi ne sherbime ,nuk kishte mjaftueshem sherbime ,restoran,hotele dhe lojra per femije....

Mungesa e nje qendre me standarte sherbimi mjeksor ambulant.

Mungese vendesh parkime per festat me kapacitet te madh pjesmarrje

Mungese pervoje ne sherbimet catering ne ambjente terreni.

Nevoje per me shume orientim me tabela dhe pershkrim te historik te atraksioneve .



Per te arritur gjithe objektivat ne pozicionimin e turizmit si drejtimin me te rendesishem per zhvillimin e komunitetit ,stafi i turizmit ne bashkepunim me gjithe grupet e interesit jane te vendosur te ballafaqohen me cdo sfide per te hartuar nje strategji lokale per turizmin ne Bashkine Librazhd. Impakti i gjithe aktiviteve tona ne bashkepunim do kontribuojne ne instalimin dhe zhvillimin e nje turizmi te qendrueshem per te ardhmen e sigurte te komunitetit tone. Perpjekjet maksimale per integrimin e cdo procesi me zhvillimin turistik do te kontribuojne me shume ne:

Rritjen e standartit te organizimit te festave lokale si nxitje per te vleresuar me shume vlerat turistike te zonave me rendesi.

Zgjidhje te qendrueshme per menaxhimin e mbetjeve prane zonave te mbrojtura dhe ne fshtarat me problem te mbetjeve.

Sigurim vend parkimi per aktivitetet me pjesmarrje masive.

Praktikim vendosje takse modeste ne hyrjen e parkut Shebenik.

Ndergjegjesim i operatoreve per rritjen e cilesise dhe standarteve te sherbimeve.

Turizmi do ndikojë drejtpërdrejt në përditshmërinë e punës së strukturës së turizmit në bashki duke e mbështetur në veprimtarinë e saj dhe shënuar ndikim në promovimin e vlerave dhe resurseve turistike në zonë, përgjigje ndaj nevojave të komunitetit për ndërgjegjësim, informacion dhe mbështetje. Të rinjtë do angazhohen në praktika konkrete dhe do jenë më të ndërgjegjësuar se si të shfrytëzojnë mundësitë që zona ofron. I vendosur shumë pranë zonave të tjera turistike, zhvillimi dhe patja e një komuniteti të përgatitur në bashkinë Librazhd do ndikonte dhe cilësinë e turizmit në gjithë rajonin veri lindor të të Shqipërisë, kjo për shkak se panorama turistike do plotësohej dhe vizitorët nuk do vërenin shkëputje por do gjenin një klimë dhe atraksione për t'u ndalur përgjatë gjithë rrugëtimit. Gjithashtu ndikimi afatgjate eshte:

Krijimi i modeleve te suksesshme nga sipermarresit me aktivite turistike.

Te ardhura per buxhetin e bashkise nga vjelja e taksave pas fuqizimit te operatoreve.

Te rinjte do jene sipermarres inovatore ne vendin e tyre duke frenuar boshatisjen ne drejtim te kerkim punesimi jashte shqiperise.

Vazhdimesia per 2025 :

Sipas kalendarit te zbatimit te aktiviteve ne sektorin e turizmit po paraqitim nje nder aktivitetet me gjithperfhires ne aspektet e promovimit ,ndergjegjesimit,integrimin me cdo strukture qe luan rol per zhvillimin e turizmit.

Kemi planifikuar te vendosim perballe njeri- tjetrit ne nje ndeshje futbollit ,2 skuadra :



1- Skuadra e operatoreve 2- Skuadra e turisteve. Sigurisht eshte nje aktivitet ku do perfshihen te rinj ,komunitet dhe turiste si tifoze ku gjithe kohen informohen mbi bukurite qe ofron turizmi malor Librazhd.

PLANI I AKTIVITETEVE

Plani i aktiviteve			
Aktivitete		Kohëzgjatja	Rezultatet e pritshme
Qëllimi I Projektit	Potenciali dhe vlerat turistike të bashkisë Librazhd janë te identifikuar dhe promovuara në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar përmes një komuniteti aktiv dhe të përfshirë në zhvillimin e Librazhdit turistik.		
Aktiviteti 0	Tryezë e rumbullakët dhe takime për fillimin e projektit.	Java 1,Janar 25	Aktorët kyç dhe stafet që do përfshihen të informuara në lidhje me projektin, rezultatet e pritshme , dhe roli i secilit në mbarëvajtjen e tij.
Aktiviteti 0.0	Vlerësimi përfundimtar i Projektit	Qershor – 25	Rezultatet e projektit, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet të vlerësuara dhe dokumentuara në raport vlerësimi.
Produkti 1	Struktura në bashki për zhvillimin e turizmit e trajnuar dhe pajisur me mjete dhe teknika bashkëkohore për organizimin e aktivitetit , dhe promovimin e potencialit dhe vlerave turistike në bashkinë Librazhd.		
Rezultati 1.1	12 staf i bashkisë Librazhd nën strukturën e turizmit, të orientuar ne menyren e organizimit te aktivitetit dhe elementët që luajne rol ne promovim.		
Aktiviteti 1.1.	Identifikoj stafin e bashkisë përfitues te drejtpërdrejtë të projektit	Java 1 Janar 25	Stafi i identifikuar dhe mirëinformuar mbi projektin dhe roli i tyre.
Aktiviteti 1.1.	Kontraktojme ekspert dhe pregatitim palnin final per organizimin e eventit.	Shkurt 25	Stafi i bashkisë i konsultuar nga eksperti dhe plani final zbatimi.
Aktiviteti 1.1.	Takim me stafin e Bashkise dhe ndarja e roleve ne zbatim.	Shkurt 25	Stafi i bashkisë i trajnuar në tema specifike si; e bukura, fotografia dhe promovimi.



Rezultati 1.2	Stafi i bashkisë Librazhd ,struktura e turizmit të pajisur me mjetet e nevojshme per aktivitetin dhe strategjine e promovimit te vlerave turistike .		
Aktiviteti 1.2.	Realizoj proceset prokuruese për mbështetjenme produktet qe mundesojne zhvillimin e aktivitetit. Përgatitja e termave të referencës, hapja e tenderit sipas politikave të bashkisë për çdo kategori, ngritja e komitetit të vlerësimit, hartimi i kontratave dhe sigurimi i produkteve nga furnizuesit e përzgjedhur.	Mars- 2025	Mjetet logjistike të nevojshme në dispozicion.
Aktiviteti 1.2.	Përgatitja e akteve të përdorimit, dokumentacioni i nevojshëm dhe inventarizimi sipas politikave të bashkisë i aseteve.	Prill 2025	Stafi i bashkisë Librazhd i pajisur me mjetet e duhura logjistike në mbështetje të realizimit të aktiviteteve të këtij projekti dhe planeve të tyre të punës.
Rezultati 1.3	Vlerat turistike të zonës të promovuara në aktivitete lokale , kombëtare e ndërkombëtare.		
Aktiviteti 1.3.	Pregatitja e plan kalendarit për vizita të ekipit të drejtorisë së turizmit në terren.	Shkurt 2025	Drejtoria e turizmit ka një plan kalendar të detajuar në shërbim të depërtimit në zonë dhe identifikimit të gjithë potencialit turistik
Aktiviteti 1.3.	Pregatitja dhe dokumentimi i takimeve me gjithë aktoret pjesmarres ne event.	Mars 2025	Stafi siguron dosje per planin e aktivizimit te partnereve ne event.
Aktiviteti 1.3.	Trajnoj të paktën një staf për popullimin dhe mbarëvajtjen e të dhënave në dosje.	Shkurt 25	Një staf i trajnuar dhe me përgjegjësi të shtuar mbarëvajtjen e dosjeve..
Aktiviteti 1.3.	Vizita në terren dhe biseda komunitare me anëtarë të komunitetit e aktorë kyç për identifikimin e gjithë operatoreve me potencial turistik në zonë	Mars 25	Në vazhdimësi elementët ekzistues rikonfirmohen për vazhdimësinë, elementë të rinj të identifikuar, informuar, motivuar e përfshirë në veprimtari turistike.
Produkti 2	Të rinjtë në Librazhd njohin dhe promovojnë vlerat e zonës përmes të qenit pro aktivë dhe një zë në		



	zhvillimin e zonës së tyre.		
Rezultati 2.1	15 të rinj përfaqësues të 7 shkollave të mesme të Trajnuar per hapat e aktivitetit. Krijohet grupi “Të rinjtë për turizmin”.		
Aktiviteti 2.1.	Identifikimi i grupit rinor. Shpallja e konkursit “Të rinjtë për Turizmin”, përzgjedhja e 15 të rinjve në bashkëpunim me shkollat.	Mars 25	15 të rinj me potencial, të përfshirë në grupin rinor “Të rinjtë për Turizmin”
Aktiviteti 2.1.	Kontraktojmë ekspert dhe hartojmë planin e organizimit te aktiviteve .	Shkurt Mars 25	Plani I zhvillimit te aktiviteve I qartësuar nga gjithë aktoret.
Aktiviteti 2.1.	Trajnojmë të rinjtë e grupit “Të rinjtë për turizmin”.	Mars 25	Të rinjtë të trajnuar në modulet specifike të lidhura me turizmin dhe të gatshëm për të dokumentuar dhe sjellë element që promovojnë turizmin.
Rezultati 2.2	15 te rinj pajisen me materialet e nevojshme dhe organizojnë aktivitete promovuese ne nivel Bashkiak dhe fshatrat e tyre për promovimin e vlerave turistike		
Aktiviteti 2.2.	Struktura e turizmit Librazhd ndërthur në planet e punës dhe vizitat në terren të rinjtë përfaqësues të grupit.	Mars 25	Të rinjtë dhe stafet e rrugëtojnë sëbashku në zona, identifikojnë dokumentojnë resurse dhe informojnë familjet sipas nevojave.
Aktiviteti 2.2.	Të rinjtë perfitojne aftesi menaxhuese aktiviteteve duke synuar mbeshtetjen e tyre ne vazhdimesim..		Te rinjte takohen ne zone duke nxitur inovacion ne kapacitete organizative.
Rezultati 2.3	120 të rinj në 7 shkolla të mesme të bashkisë Librazhd angazhohen në aktivitete të grupit të rinjtë për turizmin duke siguruar masivitet, ndërgjegjësim dhe mundësi për pjesëmarrje për çdo të ri në shkollat e tyre.		
Aktiviteti 2.3.	Të rinjtë evidentojne eksperiencat me te mira nga aktivitetet e tyre neper shkolla ,duke sjelle bashke praktikat me te mira per eventin ne nivel Bashkie.	Mars 25	Të rinjtë dhe komunitetet të ndërgjegjësuara përmes aktiviteve masive. Burimet dhe resurset turistike të identifikuar dhe promovuar përmes këtyre aktiviteve.
Aktiviteti 2.3.	Çertifikimi të rinjve për angazhimin ne aktivitet dhe perfshirjen e tyre ne komunitet.	Mars 25	Të rinjtë motivohen për veprimtarite e tyre, si një shembull në komunitet dhe nxisin të rinj të tjerë të angazhohen.



Produkti 3	Familjet me fokus dhe potencial për tu zhvilluar në çuarjen përpara të vlerave turistike të mbështetura të promovojnë aktivitetet e tyre të iniciuara në panairë lokale e kombëtare dhe të trajnuara në zhvillimin e një plan biznesi që do të jepte qëndrueshmëri		
Rezultati 3.1	21 familjet me më shumë potencial dhe në zhvillim e sipër të ideve për gjenerim të ardhurash përmes promovimit dhe investimit të kapacitetit të tyre në turizëm të trajnuara në modulën : Plan Biznesi (Menaxhimi i Financave, Promovimi i Biznesit/aktivitetit tim).		
Aktiviteti 3.1.	Identifikimi të familjeve që do përfshihen në trajnime për strukturimin e veprimtarisë së tyre përmes planeve të biznesit.	Prill 25	Familjet të identifikuar dhe të ndërgjegjësuar për rëndësinë e përfshirjes në këto trajnime.
Aktiviteti 3.1.	Kontraktimi i ekspertit dhe përgatitja e planit të zbatimit në zhvillimin e eventit.	Mars 2025	Modulët të përgatitura nga eksperti mbi aktivitetin dhe angazhimin secilit aktor.
Aktiviteti 3.1.	Trajnimi i 21 familjeve; Plan Biznesi (Menaxhimi i Financave, Promovimi i Biznesit/aktivitetit tim).	Korrik 25	21 familje të trajnuara dhe me mundësi për të vënë njohuritë e shtuara në shërbim të veprimtarive të iniciuara prej tjerë me në fokus turizmin.
Rezultati 3.2	21 familjet të informuara dhe mbështetura për të marrë pjesë dhe paraqitur me mjetet e duhura dhe dinjitet në evente promovuese, lokale, kombëtare e ndërkombëtare.		
Aktiviteti 3.2.	Stafet e strukturës së turizmit në Librazhd identifikojnë të gjithë operatorët për të promovuar në nivel, lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.	Korrik 25	Listë e operatorëve ku mund të prezantohen familjet dhe resurset e Bashkisë Librazhd dhe nevojat për mbështetje për çdo rast.
Aktiviteti 3.2.	Familjet përfaqësuese të zonës që kanë një aktivitet të vogël duke informuar dhe marrë pjesë të aktivitetit dhe mbështetur (transport, etiketim, ambalazhim, kart vizita etj.)	Mars 25	Familjet të informuara mbështetura për të marrë pjesë në evente promovuese të të gjithë niveleve.
Aktiviteti 3.2.	Event promovues, ekspozitë për promovimin e fotografive të mara nga stafi i bashkisë, të rinjtë dhe familjet përgjatë projektit, si dhe ndarja e databazës së resurseve në mënyrë vizuale dhe atraktive.	Mars 25	Burimet dhe resurset, mundësitë dhe progresi i zonës së Librazhdit dokumentuar dhe ndarë me komunitetin dhe strukturën në nivel lokal dhe kombëtar.



Aktiviteti 3.3.	Aktivitete promovuese, dalje mediatike	Prill 25	Në fund te fundit të projektit stafi i bashkisë , përfshirë të rinjtë dhe familjet do jenë të gatshëm dhe do kërkojnë mundësi për dalje mediatike ku të mund të promovojnë dhe prononcohen për ecurinë dhe rezultatet e projektit, potencialin dhe zhvillimin turistik të zonës së Librazhdit.
------------------------	--	----------	--

